



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr.156

5 dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7841 datë 3.12.2012	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin	8425
Vendim i KM nr. 788, datë 14.11.2012	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 012148 të Fondit të Mirëbesimit të Shumë Dhuruesve ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e këtij fondi, për financimin e fazës së dytë të mbështetjes për zbatimin e nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri (EITI)	8425
Vendim i KM nr. 789, datë 14.11.2012	Për miratimin e dokumentit të amendimit numër dy të marrëveshjes së ndihmës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për qeverisjen me drejtësi e në mënyrë demokratike dhe për investimin në njerëz e rritjen ekonomike	8430
Vendim i KM nr. 790, datë 14.11.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 578, datë 29.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”	8441
Vendim i KM nr. 792, datë 14.11.2012	Për uljen e tarifës së qirasë të disa ambienteve të Pallatit të Kongreseve, me rastin e hapjes së Panairit të 15-të të Librit “Tirana 2012”	8441
Vendim i KM nr. 796, datë 14.11.2012	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 15 bashki dhe 23 komuna	8442

Vendim i KM nr. 800, datë 14.11.2012	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 41, datë 11.1.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret bazë, sektorët që do të mbështeten dhe masën e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2012”, të ndryshuar	8444
Udhëzim i MF nr. 25 , datë 16.11.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 26.1.2009 “Për përcaktimin e skemës së duhur për shtypjen e biletave, shpërndarjen dhe kontrollin e hedhjes së tyre në përdorim”, të ndryshuar	8444
Vendim i KMDHP nr. 3, datë 20.11.2012	Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale	8446
Udhëzim i KMDHP nr. 23, datë 20.11 2012	Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë.....	8448
Vendim i KKRT nr. 143, datë 31.10.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Alfa&Omega”	8453
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Besnik Verbofshi..	8453

DEKRET
Nr. 7841, datë 3.12.2012

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN

Në mbështetje të nenit 92 shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për Kuvendin të zhvillohen ditën e diel, më datë 23 qershor 2013.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 788, datë 14.11.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF 012148, TË FONDIT TË MIRËBESIMIT TË SHUMË DHURUESVE, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E KËTJ FONDIT, PËR FINANCIMIN E FAZËS SË DYTË TË MBËSHTETJES PËR ZBATIMIN E NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE NË SHQIPËRI (EITI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 012148 të Fondit të Mirëbesimit të Shumë Dhuruesve, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e këtij fondi, për financimin e fazës së dytë të mbështetjes për zbatimin e nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri (EITI).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



BANKA BOTËRORE
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM
NDËRKOMBËTAR

1818 H Street N.W. Washington,
D.C. 20433,
USA

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS

18 qershor 2012
Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4, Tirana, ALBANIA

FONDI I BESIMIT ME SHUMË DONATORË PËR SHQIPËRINË
PËR INICIATIVËN PËR TRANSPARENCË TË INDUSTRIJË NXJERRËSE (EITI)
ZBATIMI I FAZËS II
GRANTI NR. TF012148

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (Përfituesi), kam kënaqësinë t'ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e administratorit të fondeve të grantit të dhënë nga Australia, Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Bashkimi Europian, përfaqësuar nga Komisioni Europian, Finlanda, Franca, Gjermania, Japonia, Holanda, Norvegjia, Spanja, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (donatorët), në bazë të Fondit të Besimit me Shumë Donatorë për Shqipërinë për Iniciativën për Transparencë të Industrisë Nxjerrëse (EITI), propozon t'i japë Përfituesit një grant në shumën që nuk tejkalon njëqind e dhjetë mijë dollarë amerikanë (110,000 US \$) (granti), sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në këtë dokument marrëveshjeje (marrëveshja), e cila përfshin aneksin bashkëlidhur, për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në aneksin (projekti).

Ky grant financohet nga fondi i lartpërmendur i besimit, për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga donatorët. Në pajtim me seksionin 3.02 të kushteve standarde (siç përcaktohet në aneksin e kësaj marrëveshjeje), detyrimet e pagesave të Bankës Botërore në lidhje me këtë marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve të vëna në dispozicion të saj nga donatorët, sipas fondit të lartpërmendur, dhe e drejta e Përfituesit të tërheqë të ardhurat nga granti i nënshtrohet disponueshmërisë së këtyre fondeve. Kështu, në rast se ndonjë prej donatorëve për ndonjë arsye anulon apo nuk paguan ndonjë kontribut sipas fondit të besimit të Bankës Botërore ose që si rezultat i ndryshimeve të këmbimit valutor, shuma e fondeve në dispozicion në fondin e besimit është e pamjaftueshme për qëllime të grantit, Përfituesi do të mbartë rrezikun e mungesave të këtij financimi dhe Banka Botërore nuk do të ketë asnjë lloj detyrimi ndaj Përfituesit ose palëve të treta në lidhje me shpenzimet ose detyrimet e shkaktuara nga Përfituesi ose palët e treta në lidhje me këtë marrëveshje, të cilat tejkalojnë shumën e fondeve të vëna në dispozicion të Bankës Botërore nga donatorët për qëllime të grantit.

Përfituesi përfaqëson, duke konfirmuar marrëveshjen më poshtë, se është i autorizuar për të lidhur këtë marrëveshje dhe për të zbatuar projektin në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruar ose të përmendur në këtë marrëveshje.

Ju lutem, konfirmoni miratimin e Përfituesit për sa më sipër, duke vendosur emrin e një zyrtari të autorizuar nga Përfituesi për të nënshkruar dhe për të vënë datën, kopjen e bashkëlidhur të marrëveshjes, dhe duke ia kthyer atë Bankës Botërore. Pas marrjes së kësaj kopjeje të sigluar, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit nga Përfituesi në lidhje me përfundimin e procedurave të saj të brendshme, me kusht që marrëveshja të konsiderohet e tërhequr, nëse Banka Botërore nuk ka marrë kopje të sigluara të marrëveshjes dhe njoftimin përkatës brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, nga ana e Bankës Botërore, nëse Banka Botërore dhe Përfituesi nuk kanë caktuar një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Anthony A. Gaeta
Drejtori i Komanduar për Ballkanin Perëndimor, Europën dhe Azinë Qendrore

**RËNË DAKORD:
SHQIPËRIA**

Nga _____
Përfaqësuesi i autorizuar
Emri _____
Pozicioni _____
Data _____
Shtojca:

1. Kushtet standarde për grantet hartuara nga Banka Botërore për fonde të ndryshme, 15 shkurt 2012.
2. Letër disbursimi në të njëjtën datë me marrëveshjen, së bashku me udhëzimet e disbursimit për projekte të Bankës Botërore, datë 1 maj 2006.
3. Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga “Huatë e BERZH-it dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, datë 15 tetor 2006 dhe rishikuar në janar 2011.
4. Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsultative sipas “Huas së BERZH-it dhe kredive dhe granteve të IDA-s” nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011.
5. Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve, sipas huave të BERZH-it dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011.

TF012148
ANEKS

Neni 1

Kushtet standarde, përkufizimet

1.01 Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet e marra nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme të datës 15 shkurt 2012 (kushtet standarde) përbëjnë pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

1.02 Përkufizimet. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në kushtet standarde apo në këtë Marrëveshjeje.

“Grupi i punës me shumë aktorë” ose “MSWG” nënkupton një grup të përbërë nga përfaqësues të qeverisë përfituese, kompanitë minerare dhe shoqërinë civile, dhe të ngritura nga Përfituesi, si një forum, ku të gjitha vendimet në lidhje me procesin e EITI do të diskutohen dhe do të bihen dakord.

Neni 2

Zbatimi i projektit

2.01 Objektivat dhe përshkrimi i projektit. Objektivat e projektit janë marrja e rekomandimeve të vlerësuesit për të mundësuar përfundimin me sukses të procesit të vlefshmërisë të filluar në maj 2011, me përgatitjen e raportit të dytë EITI dhe për të plotësuar fondin ekzistues të besimit me shumë donatorë, i cili do të mbetet në fuqi deri më 30 qershor 2012 dhe që vazhdon të financojë aktivitete të ndryshme që lidhen me ndërtimin e kapaciteteve, komunikimin dhe angazhimin me burime, dhe mbështetjen e Sekretariatit. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A. Përgatitja dhe shpërndarja e një raporti të dytë EITI



- Ofrimi i asistencës teknike për administratorin e pavarur dhe procesin e pajtimit.
- Realizimin e një seminari mbi lançues mbi shpërndarjen.

2.02 Zbatimi i projektit në përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi do të zbatojë projektin nëpërmjet Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), në përputhje me dispozitat e: a) seksioni II i kushteve standarde; b) udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga kreditë e BERZH-it dhe kreditë dhe grantet e IDA-s, datë 15 tetor 2006 dhe i rishikuar në janar 2011 (udhëzimet e antikorupsionit); dhe c) të këtij seksioni II.

2.03 Masat institucionale dhe masa të tjera

a) METE do të mbajë në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit, Sekretariatit EITI pranë METE-s, i cili do të jetë përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve të projektit dhe operacionet e tij të përditshme. Në çdo kohë, gjatë të gjithë zbatimit të projektit, Përfituesi do t'i sigurojë Sekretariatit EITI ambiente zyre, pajisje dhe furnizime të nevojshme zyre dhe do të mbulojë të gjitha shërbimet publike.

b) Përfituesi nuk do të përdorë të ardhurat e grantit për qëllimin e ndonjë pagese ndaj personave ose subjekteve ose për importin e mallrave, nëse pagesa të tilla ose importe, sipas dënjës apo mendimit të Përfituesit, është e ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, bazuar në kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1373 dhe rezolutave të ngjashme.

2.04 Vizibiliteti i donatorëve dhe vizitat e donatorëve

a) Përfituesi duhet të ndërmarrë ose të shkaktojë marrjen e të gjitha masave që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e donatorit për projektin.

b) Përfituesi duhet që, me kërkesë të Bankës Botërore, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar përfaqësimin e donatorëve (s) për të vizituar çdo pjesë të territorit të Përfituesit për qëllime që lidhen me projektin.

2.05 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit

a) Përfituesi duhet të monitorojë dhe të vlerësojë progresin e projektit dhe të përgatitë raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. Çdo raport projekti do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t'i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë.

b) Përfituesi duhet të përgatitë raportin përfundimtar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti përfundimtar duhet t'i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.06 Menaxhimi financiar

a) Përfituesi duhet të garantojë që një sistem menaxhimi financiar të mbahet në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Përfituesi duhet të garantojë që raportet e ndërmjetme financiare të paaudituar për projektin të jenë përgatitur dhe dhënë Bankës Botërore, si pjesë e raportit të projektit jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik që mbulon tremujorin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka Botërore.

c) Përfituesi duhet që, me kërkesë të Bankës Botërore, të disponojë pasqyrat financiare të audituara në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 (b) të kushteve standarde. Ky auditim i pasqyrave financiare duhet të mbulojë të gjithë periudhën gjatë së cilës janë bërë tërheqjet e grantit. Pasqyrat financiare të audituara për këtë periudhë do t'i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.07 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, punimet, shërbimet jokonsultative dhe/ose shërbimet e konsulencës të kërkuara për projektin dhe të financuara plotësisht ose pjesërisht nga të ardhurat e grantit, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashtruara ose të përmendura në:

i) Seksionin I të “Udhëzimeve: prokurimi i mallrave, i punimeve dhe i shërbimeve jokonsultative, sipas huave të BERZH-it dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, datë 20 janar 2011 (udhëzimet e prokurimit), në rastin e mallrave; dhe

ii) Seksionet I dhe IV të “Udhëzimet: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nën kreditë BERZH dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011 (udhëzimet e konsulentit) në rastin e shërbimeve të konsulentëve;

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga Banka Botërore për kontrata të veçanta, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në udhëzimet e prokurimit ose udhëzimet për konsulentët, sipas rastit.

c) Metodatat e veçanta të prokurimit të mallrave. Mallrat dhe shërbimet ndryshe nga shërbimet e konsulentëve do të prokurohen nën një kontratë të hartuar mbi bazën e blerjeve dhe të kontraktimit të drejtpërdrejtë (DC). Kjo kontratë (DC) mund të përdoret, në bazë të miratimit paraprak të Bankës, për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, ndryshe nga shërbimet e konsulentëve që përmbushin kërkesat për DC, të përmendura në paragrafin 3.6 të udhëzimeve të prokurimit.

d) Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Metodatat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve, për ato detyra, për të cilat Banka Botërore pranon se plotësojnë kërkesat e përcaktuara në udhëzimet për konsulentët për përdorim nga ana e tyre: A) cilësia dhe përzgjedhja e bazuar në kosto; B) Përzgjedhja sipas buxhetit fiks; C) përzgjedhja me koston më të ulët; D) përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; E) përzgjedhja me burim të vetëm; dhe P) përzgjedhja e konsulentëve individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit. Përveç rasteve kur Banka Botërore do të duhet të përcaktojë me anë të një njoftimi drejtuar Përfituesit, kontratat e mëposhtme duhet t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga Banka Botërore: a) dy kontratat e para duhet të jepen në përputhje me metodën e blerjeve; b) termat e referencës për çdo kontratë për shërbimet e konsulentëve; c) çdo kontratë për shërbimet e konsulentëve me një firmë/kompani të vlerësuar me kosto të barasvlershme prej 50.000 \$ ose më shumë; d) çdo kontratë për shërbimet e konsulentëve me një konsulent individual, të vlerësuar me kosto të barasvlershme prej 25.000 \$ ose më shumë; dhe e) të gjitha kontratat ku zbatohen metodatat e kontraktimit të drejtpërdrejtë ose të përzgjedhjes me burim të vetëm. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen shqyrtimit të mëpasshëm nga Banka Botërore.

Neni 3

Tërheqja e shumave të grantit

3.01 Shpenzimet e lejuara. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat e grantit në përputhje me dispozitat e: a) seksionit III të kushteve standarde; b) këtij seksioni; dhe c) me disa udhëzime shtesë, që Banka Botërore mund të specifikojë duke njoftuar Përfituesin (duke përfshirë “Udhëzimet e disbursimit për projektet e Bankës Botërore” të muajit maj 2006, të rishikuar herë pas here nga Banka Botërore dhe të bërë të zbatueshme për këtë marrëveshje në bazë të këtyre udhëzimeve), për financimin e shpenzimeve të lejueshme, të përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Tabela specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat e grantit (kategoria), alokimet e shumave të grantit për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar për shpenzimet e lejuara në çdo kategori.

Kategoria	Shuma e grantit e alokuar (e shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (së bashku me taksat)
Shërbimet e konsulencës dhe trajnimet	110,000	100%
SHUMA TOTALE	110,000	



Për qëllime të këtij seksioni:

a) Termi “trajnim” do të thotë veprimtaritë e organizuara dhe të realizuara në kuadër të projektit, duke përfshirë blerjen dhe publikimin e materialeve, qiramarrjen e objekteve dhe të pajisjeve, shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të pjesëmarrësve të seminarit.

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e bëra para datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga të dyja palët propozuar nga Përfituesi.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 22 tetor 2012.

Neni 4

Përfaqësuesi i përfituesit, adresat

4.01 Përfaqësuesi i Përfituesit. Përfaqësuesi i Përfituesit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

4.02 Adresa e Përfituesit. Adresa e Përfituesit e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4
Tiranë

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States Of America
Faks: 1- 202-477-6391

VENDIM

Nr. 789, datë 14.11.2012

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË AMENDIMIT NUMËR DY TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR QEVERISJEN ME DREJTËSI E NË MËNYRË DEMOKRATIKE DHE PËR INVESTIMIN NË NJERËZ E RRIJTJEN EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të amendimit numër dy të marrëveshjes së ndihmës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për qeverisjen me drejtësi e në mënyrë demokratike dhe për investimin në njerëz e rritjen ekonomike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE E NDIHMËS SË USAID-IT NR. 182-AOAG-10-001-02
AMENDIM NUMËR DY I MARRËVESHJES SË NDIHMËS
NDËRMJET QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR QEVERISJEN ME DREJTËSI DHE NË
MËNYRË DEMOKRATIKE; INVESTIMIN NË NJERËZ DHE RRITJEN EKONOMIKE
DATË 14 SHTATOR 2012

Ndërmjet qeverisë së Shteteve të Bashkuara që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë e quajtur “Përfituesi i grantit”).

1. Qëllimi i amendimit

Ky amendim numër dy i marrëveshjes së ndihmës të USAID-it i datës 30 shtator 2010 (marrëveshja) lidhet ndërmjet palëve me qëllim: i) që t’i japë Përfituesit të grantit një ndihmë shtesë prej nëntë milionë, e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë, e nëntëdhjetë e nëntë dollarë amerikanë (USD) (\$9,625,099) dhe të modifikojë respektivisht buxhetin; dhe ii) të lejojë financimin direkt të Përfituesit të grantit. Kjo shumë shtesë e fondeve e bën shumën totale të caktuar deri në këtë datë, sipas marrëveshjes, në një shumë që nuk kalon njëzet e katër milionë, e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë, e nëntëqind e dymbëdhjetë dollarë amerikanë (\$24,626,912).

2. Kontributet e palëve

Neni 3 seksioni 3.1 (a) i marrëveshjes shfuqizohet plotësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

Seksioni 3.1 Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të vendosur në këtë marrëveshje, USAID-i, në përputhje me aktin e ndihmës së huaj të vitit 1961, siç është amenduar, për vitin fiskal (VF) 2012, i jep Përfituesit të grantit, sipas kushteve të marrëveshjes, një shumë që nuk kalon njëzet e katër milionë, e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë, e nëntëqind e dymbëdhjetë dollarë amerikanë (\$24,626,912).

Neni 3 seksioni 3.1 (c) i marrëveshjes fshihet plotësisht dhe paragrafi (d) rinumërohet si paragrafi (c).

3. Data e përfundimit

Një paragraf i ri (c) shtohet te neni 4 si më poshtë:

c) Kërkesat për disbursim, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbështetës, të rekomanduar në shkresat e zbatimit, duhen marrë nga USAID-i jo më vonë se 9 (nëntë) muaj pas datës së përfundimit ose pas ndonjë periudhe tjetër të pranuar me shkrim nga USAID-i para ose pas kësaj periudhe. Pas kësaj periudhe, USAID-i, në çdo kohë mund t’i bëjë njoftim me shkrim Përfituesit të grantit dhe të zvogëlojë shumën e grantit, të tërën ose pjesërisht, në rast se kërkesat për disbursim të saj, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbështetës, të rekomanduar në shkresat e zbatimit, nuk janë marrë nga USAID-i para mbarimit të kësaj periudhe.

4. Rolet dhe përgjegjësitë

Neni IV seksioni B i shtojcës 1 fshihet plotësisht, dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

B. USAID-i

USAID-i do të koordinojë dhe do të komunikojë me Përfituesin e grantit për të arritur me sukses objektivat dhe rezultatet, siç janë shqyrtuar në këtë marrëveshje.

USAID-i lidh një ose më shumë marrëveshje me një ose më shumë partnerë zbatues, palë të treta (partnerë zbatues) për të realizuar aktivitetet sipas kësaj marrëveshjeje. Këto marrëveshje mund të përfshijnë grante, marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata. Partnerë zbatues mund të jenë organizata ose individë: lokale, nga Shtetet e Bashkuara, ndërkombëtare ose shumëkombëshe, qeveritare ose joqeveritare. USAID-i i përzgjedh partnerët zbatues në përputhje me rregulloret dhe politikat e USAID-it.

USAID-i monitoron performancën sipas këtyre marrëveshjeve dhe monitoron performancën e Partnerëve zbatues dhe ecurinë drejt arritjes së rezultateve.



USAID-i i jep Përfituesit të grantit informacion mbi disbursimet që lidhen me këtë marrëveshje në një formë dhe përmbajtje të rënë dakord ndërmjet të dyja palëve.

5. Plani financiar

Plani financiar nën shtojcën 1, përshkrimi i zgjeruar, seksioni V, fshihet tërësisht dhe zëvendësohet nga shtojca A bashkëlidhur “Plani financiar ilustrues i modifikuar nëpërmjet amendimit numër dy”.

6. Dispozita standarde

Dispozitat standarde në aneksin 2 fshihen tërësisht dhe zëvendësohen nga shtojca B bashkëlidhur “Dispozitat standarde të modifikuara nëpërmjet amendimit numër dy”.

7. Rregullat dhe kushtet e tjera

Përveç sa amenduar këtu, të gjitha rregullat dhe kushtet e tjera të marrëveshjes mbeten plotësisht në fuqi. Të gjithë termat me germa kapitale në këtë amendim numër dy do të kenë kuptimet që u jepen atyre në marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përfituesi i grantit, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky amendim numër dy i marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

QEVERIA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË
AMERIKËS

QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Nga: _____

Datë: 14.9.2012 _____

Datë: _____

Emri: Jim Barnhart

Emri: Ridvan Bode

Pozicioni: Drejtues misioni, USAID/Shqipëri

Pozicioni: Ministër i Financave

SHTOJCA A PLANI FINANCIAR ILUSTRUES I NDRYSHUAR NËPËRMJET AMENDIMIT NUMËR DY

V. Plani financiar

Plani financiar ilustrues i ndryshuar nëpërmjet amendimit numër dy “Plani financiar”, paraqitet më poshtë, ndryshimet në planin financiar mund të bëhen me shkrim nga përfaqësuesit e autorizuar pa ndryshim zyrtar të marrëveshjes, nëse këto ndryshime nuk përbëjnë shkak që kontributi i USAID-it të tejkalojë shumën e specifikuar në seksionin 3.1 (a) të marrëveshjes, të ndryshuar.

Fonde të USAID-it për asistencën e huaj

Fusha e programit	Totali	
	VF 2012	VF 2010-2015
1. Shëndetësia	\$2,483,000	\$11,000,000
2. Shteti ligjor	\$2,500,000	\$12,000,000
3. Qeverisje e mirë	\$7,550,000	\$12,000,000
4. Shoqëri civile		\$1,000,000
5. Tregti dhe investime	\$1,150,000	\$3,000,000
6. Sektori financiar	\$2,038,248	\$2,000,000
7. Infrastrukturë	\$1,164,366	\$5,000,000
8. Bujqësi		\$10,000,000
9. Konkurrueshmëri e sektorit privat	\$5,987,645	\$14,000,000
10. Mbështetje e programit	\$1,753,653	\$5,000,000
TOTALI	\$ 24,626,912	\$75,000,000

SHTOJCA B

ANEKSI 2 DISPOZITA STANDARDE TË NDRYSHUARA NËPËRMJET AMENDAMENTIT NUMËR DY

Përmbajtja

Neni A: Përkufizimet dhe dokumentet e zbatimit

Seksioni A.1 Përkufizimet

Seksioni A.2 Dokumentet e zbatimit

Neni B: Kërkesa të përgjithshme

Seksioni B.1 Konsulenca

Seksioni B.2 Zbatimi i marrëveshjes

Seksioni B.3 Përdorimi i mallrave dhe i shërbimeve

Seksioni B.4 Taksimi

Seksioni B.5 Raportet dhe informacioni, regjistrat dhe të dhënat, auditimet dhe inspektimet

Seksioni B.6 Plotësimi i informacionit

Seksioni B.7 PAGESA TË TJERA

Seksioni B.8 Informacioni dhe identifikimi

Neni C: Dispozitat e prokurimit

Seksioni C.1 Origjina dhe kombësia

Seksioni C.2 Data e vlefshmërisë

Seksioni C.3 Planet, specifikimet dhe kontratat

Seksioni C.4 Çmimi i arsyeshëm

Seksioni C.5 Njoftimi i furnitorëve potencialë

Seksioni C.6 Transportimi

Seksioni C.7 Sigurimi

Seksioni C.8 Pasuria që tepron në pronësi të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

Neni D: Disbursimet

Seksioni D.1 Disbursimet

Seksioni D.2 Kursi i këmbimit

Neni E: Përfundimi; dëshmipërblimet

Seksioni E.1 Pezullimi dhe përfundimi

Seksioni E.2 Rifinancimi

Seksioni E.3 Dëshmipërblimet e detyrueshme

Seksioni E.4 Transferimi

Neni F: Të ndryshme

Seksioni F.1 Promovimi i investimit

Seksioni F.2 Planifikimi familjar vullnetar

Seksioni F.3 Moslejimi i ndihmës për trafikuesit e drogës

Seksioni F.4 Të drejtat e punëtorëve

Seksioni F.5 Moslejimi i financimit të delegacioneve të qeverive të huaja në Konferenca

Ndërkombëtare

Neni A: Përkufizime dhe dokumente zbatimi

Seksioni A.1 Përkufizime. E përdorur në këtë aneks “marrëveshje”, i referohet marrëveshjes së asistencës, së cilës i bashkëlidhet ky aneks dhe pjesë të së cilës përbën ky aneks. Termat e përdorur në këtë aneks kanë të njëjtin kuptim ose referencë si marrëveshja.

Seksioni A.2 Dokumentet e zbatimit. Për të ndihmuar Përfituesin e grantit në zbatimin e marrëveshjes, USAID-i herë pas here lëshon dokumente zbatimi “dokumente zbatimi”, që japin informacion shtesë në lidhje me çështjet e përcaktuara në këtë marrëveshje. Palët mund të lëshojnë gjithashtu dokumente zbatimi të miratuara bashkërisht për të konfirmuar dhe për të regjistruar



mirëkuptimin e tyre reciprok për aspekte të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Dokumentet e zbatimit mund të lëshohen gjithashtu për të regjistruar rishikimet ose përjashtimet që lejohen nga kjo marrëveshje.

Neni B: Kërkesa të përgjithshme

Seksioni B.1 Konsulenca. Palët bashkëpunojnë për të garantuar arritjen e objektivave dhe rezultateve të kësaj marrëveshjeje. Për këtë qëllim, palët, me kërkesë të secilës, shkëmbejnë mendime mbi përparimin drejt objektivave dhe rezultateve, përbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje, punën e çdo konsulenti, kontraktori ose furnitori të përfshirë sipas marrëveshjes dhe çështje të tjera në lidhje me këtë marrëveshje.

Seksioni B.2 Ekzekutimi i marrëveshjes. Përfituesi i grantit:

a) përbush marrëveshjen dhe aktivitete që kërkohen të ndërmerren drejtpërdrejt (ose për të cilat duhen të marren masa) nga Përfituesi i grantit ose të marrin masa për përbushjen e kësaj marrëveshjeje dhe aktiviteteve me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, në pajtim me praktikën e qëndrueshme teknike, financiare dhe menaxheriale dhe në pajtim me dokumentet, planet, specifikimet, kontratat, programet ose masat e tjera dhe me modifikimet e tyre, të aprovuara nga USAID-i, në pajtim me këtë marrëveshje; dhe

b) ofron personel menaxhues të kualifikuar dhe me përvojë dhe e trajnon personelin rregullisht për mbajtjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të financuara sipas kësaj marrëveshjeje dhe, sipas rastit, për aktivitetet në vazhdim, merr masa që këto aktivitete të operohen dhe mbahen në mënyrë të tillë që të garantohet arritja e vazhdueshme dhe e suksesshme e objektivave dhe rezultateve sipas marrëveshjes.

Seksioni B.3. Përdorimi i mallrave dhe i shërbimeve. Çdo mall ose shërbim i financuar sipas kësaj marrëveshjeje, përveç kur është rënë dakord ndryshe me shkrim nga USAID-i, i dedikohet marrëveshjes deri në përfundimin ose prishjen e kësaj të fundit, dhe pas kësaj (si dhe gjatë çdo periudhe pezullimi të marrëveshjes) do të përdoret për arritjen e objektivit dhe rezultateve të marrëveshjes ose siç mund të udhëzojë USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni B.4 Taksimi:

a) Përjashtim i përgjithshëm. Marrëveshja dhe asistenca sipas saj përjashtohen nga çdo tatim i caktuar sipas ligjeve në fuqi në territorin e Përfituesit të grantit.

b) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, përjashtimi i përgjithshëm i nënseksionit (a) zbatohet, pa u kufizuar, në: 1) çdo aktivitet, kontratë, grant ose marrëveshje tjetër zbatuese të financuar nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje; 2) çdo veprim ose furnizim, pajisje, materiale, pronë ose mallra të tjera (këtu të quajtura bashkërisht “mallra” sipas pikës 1 më sipër; 3) çdo kontraktor, përfitues granti ose organizatë tjetër që kryen aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje; 4) çdo punonjës i këtyre organizatave; dhe 5) çdo kontraktor individual ose përfitues granti, i cili kryen aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje.

c) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, përjashtimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por pa u kufizuar për tatimet e mëposhtme:

1. Përjashtimi 1. Detyrimet doganore, tarifatat, tatimi mbi importin ose detyrime të tjera mbi importimin, përdorimin dhe riekspertimin e mallrave ose të sendeve personale (duke përfshirë automjetet në pronësi private) për përdorimin personal të individëve jo vendas ose të anëtarëve të familjeve të tyre. Përjashtimi 1 përfshin, pa u kufizuar, të gjitha detyrimet e bazuara në vlerën e këtyre mallrave të importuara, por nuk përfshin detyrimet e shërbimit drejtpërdrejt të lidhura me shërbimet e kryera për transferimin e mallrave ose sendeve.

2. Përjashtimi 2. Tatimin mbi të ardhurat, fitimet ose pronën e të gjithë: i) organizatave jo vendase të çdo lloji; ii) punonjësit jo vendas të organizatave vendase ose jo vendase; ose iii) kontraktorët ose Përfituesit e grantit individualë jo vendas. Përjashtimi 2 përfshin të ardhurat dhe taksat për sigurimet shoqërore të të gjithë tipave dhe të gjitha taksat mbi pasurinë, personale ose të patundshme, në pronësi të këtyre organizatave ose personave jo vendas. Termi “vendas” u referohet organizatave të themeluara sipas ligjeve të Përfituesit të grantit dhe shtetasve të Përfituesit të grantit, të ndryshëm nga shtetasit e huaj me qëndrim të përhershëm në Shtetet e Bashkuara.

3. Përjashtimi 3. Tatimet e vendosura për veprimin e fundit për blerjen e mallrave ose shërbimeve të financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë taksat e shitjes, taksat mbi vlerën e shtuar (TVSH) ose tatimet për blerjen ose rentën e pasurisë së patundshme ose personale.

Termi “veprim i fundit” i referohet veprimit të fundit nëpërmjet të cilit blihen mallrat ose shërbimet për përdorim në aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje.

d) Nëse një taksë është vendosur dhe paguar në kundërshtim me dispozitat e një përjashtimi, USAID-i, sipas diskrecionit të tij, mund: 1) t’i kërkojë Përfituesit të grantit të kompensojë USAID-in ose të tjerë sipas udhëzimit të UDSAID-it me shumën e këtyre taksave me fonde të ndryshme nga ato të dhëna sipas marrëveshjes; ose 2) të kompensojë shumën e kësaj takse me shumat që duhet të disbursohen sipas kësaj ose një marrëveshjeje tjetër ndërmjet palëve.

e) Në rastin e një mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin e një përjashtimi, palët bien dakord të takohen menjëherë dhe të zgjidhin këto çështje, të udhëhequra nga parimi që asistenca nga USAID-i përjashtohet nga tatimi i drejtpërdrejtë, kështu që e gjithë asistenca e dhënë nga USAID-i do të kontribuojë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit të Përfituesit të grantit.

Seksioni B.5. Raportet dhe informacioni, librat dhe regjistrat, auditimet dhe inspektimet sipas marrëveshjes

a) Raportet dhe informacioni. Përfituesi i jep USAID-it regjistrat e kontabilitetit dhe informacion dhe raporte të tjera në lidhje me marrëveshjen që USAID-i mund t’i kërkojë.

b) Librat dhe regjistrat e grantmarrëveshjes. Përfituesi i grantit do të mbajë librat e kontabilitetit, shënimet, dokumentet dhe dëshmitë e tjera në lidhje me marrëveshjen, të mjaftueshme për të përcaktuar, pa kufizim, të gjitha kostot e shkaktuara direkt nga Përfituesi i grantit, sipas marrëveshjes, marrjen dhe përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të blera nga Përfituesi i grantit sipas marrëveshjes, kërkesat e ndarjes së kostos për të cilat është rënë dakord, natyrën dhe shkallën e kërkesave të furnitorëve potencialë të mallrave dhe shërbimeve të përfutuara nga Përfituesi i grantit, bazën e dhënies së kontratave dhe urdhrave të kryera direkt nga Përfituesi i grantit, si dhe përparimin e përgjithshëm të marrëveshjes drejt përfundimit “Librat dhe regjistrat e marrëveshjes”. Përfituesi i grantit do të mbajë librat dhe regjistrat e marrëveshjes në përputhje me parimet e kontabilitetit, të pranuar përgjithësisht që mbizotërojnë në Shtetet e Bashkuara ose në opsionin e Përfituesit të grantit, me miratim nga USAID-i, me parime të tjera të kontabilitetit, të tilla si ato: 1) të përshkruara nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (një filial i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve); ose 2) që mbizotërojnë në shtetin e Përfituesit të grantit. Librat dhe regjistrat e marrëveshjes do të mbahen për të paktën tre vjet pas datës së disbursimit të fundit nga USAID-i ose për një periudhë më të gjatë, nëse ka, të nevojshme për të zgjidhur ndonjë çështje gjyqësore, pretendimet ose rezultatet e auditimit. Për shmangien e dyshimit, ky seksion B.5 (b) zbatohet vetëm për fondet e grantit të shpenzuara drejtpërdrejt nga Përfituesi i grantit.

c) Auditimi i grantit. Nëse 300.000\$ ose më shumë prej fondeve të USAID-it janë shpenzuar drejtpërdrejt nga Përfituesi i grantit në vitin e tij fiskal sipas marrëveshjes, Përfituesi i grantit do të sigurojë auditime financiare të shpenzimeve në përputhje me kushtet e mëposhtme, përveç rasteve kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim:

1. Me miratimin e USAID-it, Përfituesi i grantit do të përdorë institucionin e vet suprem të auditimit ose do të zgjedhë një auditues të pavarur në përputhje me “udhëzimet për kontrollin financiar të kontraktuara nga përfituesit e huaj”, të lëshuara nga inspektori i përgjithshëm i USAID-it “Udhëzimet” dhe auditimet do të kryhen në përputhje me “udhëzimet”; dhe

2. Auditimi do të përcaktojë nëse marrja dhe shpenzimi i fondeve të siguruara sipas marrëveshjes paraqiten në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht, siç bihet dakord me paragrafin (b) më sipër dhe nëse Përfituesi i grantit është në pajtim me kushtet e marrëveshjes. Çdo kontroll financiar do të përfundojë jo më vonë se nëntë muaj pas mbylljes së vitit, që është nën auditim të Përfituesit të grantit.

d) Auditimet e nënpërfituesit. Përfituesi i grantit, përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t’i dorëzojë USAID-it, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për USAID-in, një plan për auditimin e shpenzimeve të nënpërfituesve “të mbuluar”, të përcaktuara si më poshtë, që marrin fonde në lidhje me një kontratë të drejtpërdrejtë ose në marrëveshje të bërë drejtpërdrejt me Përfituesin e grantit në përputhje me aktivitetet e parashikuara nga kjo marrëveshje.



1. Një nënpërfitues “i mbuluar” është ai që shpenzon 300.000\$ ose më shumë në vitin e saj fiskal në kontratat e “USAID-it” (domethënë si nënpërfitues sipas objektivit strategjik të USAID-it dhe marrëveshjeve të tjera të grantit me qeveritë e huaja).

2. Plani do të përshkruajë metodologjinë që do të përdoret nga ana e Përfituesit të grantit për të përmbushur përgjegjësitë e veta të auditimit për nënpërfituesit “e mbuluar”. Përfituesi i grantit mund të përmbushë përgjegjësi të tilla të auditimit, duke u mbështetur në kontrollet e pavarura të nënpërfituesve; duke zgjeruar fushëveprimin e auditimit të pavarur financiar të Përfituesit të grantit për të përfshirë testimin e llogarive të nënpërfituesve, ose një kombinim të këtyre procedurave.

3. Plani do të identifikojë fondet e vëna në dispozicion për nënpërfituesit “e mbuluar”, që do të mbulohen nga auditimet e kryera në përputhje me dispozitat e tjera të auditimit, të cilat do të përmbushnin përgjegjësitë e auditimit të Përfituesit të grantit. (Një organizatë jofitimprurëse e organizuar në Shtetet e Bashkuara duhet të marrë masa për kontrollet e veta financiare. Një kontraktor fitimprurës i organizuar në Shtetet e Bashkuara, që ka një kontratë të drejtpërdrejtë me USAID-in, auditohet nga agjencia e njohur e qeverisë së SHBA-së. Një organizatë private vullnetare e organizuar jashtë Shteteve të Bashkuara me një grant të drejtpërdrejtë nga USAID-i, duhet të marrë masa për kontrollet e veta financiare. Një kontraktor nga vendi pritës duhet të auditohet nga agjencia e auditimit të Përfituesit të grantit.)

4. Përfituesi i grantit do të sigurojë që nënpërfituesit “e mbuluar”, sipas kontratave ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta me Përfituesin e grantit, të ndërmarrin veprime korrigjuese, të duhura dhe në kohë; të shqyrtojnë nëse auditimet e nënpërfituesve kërkojnë rregullime të regjistrave të tyre; dhe që çdo nënpërfitues i tillë të lejojë auditë të pavarur të kenë qasje në të dhënat dhe pasqyrat financiare sipas nevojës.

e) Raportet e auditimit. Përfituesi i grantit do t’i japë ose do të marrë masa që USAID-it t’i jepet një raport auditimi për çdo auditim të organizuar nga Përfituesi i grantit, në përputhje me këtë seksion brenda 30 ditëve pas përfundimit të auditimit dhe jo më vonë se nëntë muaj pas përfundimit të periudhës së auditimit.

f) Nënpërfituesit e tjerë të mbuluar. Për nënpërfituesit “e mbuluar”, të cilët marrin fonde sipas marrëveshjes në pajtim me kontratat ose marrëveshjet e drejtpërdrejta me USAID-in, USAID-i përfshin kërkesa përkatëse auditimi në këto kontrata ose marrëveshje dhe, në emër të Përfituesit të grantit, zhvillon aktivitete verifikuese në lidhje me raportet e auditimit, të dhëna në pajtim me këto kërkesa.

g) Kostoja e auditimeve. Në bazë të aprovimit me shkrim të USAID-it, kostot e auditimeve të kryera në pajtim me kushtet e këtij seksioni mund t’i ngarkohen marrëveshjes.

h) Kontrolli financiar nga USAID-i. USAID-i ruan të drejtën për të kryer auditime që kërkohen sipas kësaj marrëveshjeje në emër të Përfituesit të grantit, duke shfrytëzuar fondet sipas marrëveshjes ose nga burime të tjera në dispozicion të USAID-it për këtë qëllim, për të kryer një rishikim financiar ose për të siguruar ndryshe përgjegjshmërinë e organizatave që shpenzojnë fondet e USAID-it, pavarësisht nga kërkesat e auditimit.

i) Mundësia për kontroll financiar ose inspektim. Përfituesi i grantit do t’i japë mundësinë përfaqësuesve të autorizuar të USAID-it që në çdo kohë të arsyeshme të auditojë ose të inspektojë aktivitetet e financuara sipas marrëveshjes, shfrytëzimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga USAID-i dhe librat, regjistrat dhe dokumentet e tjera që lidhen me marrëveshjen.

j) Librat dhe regjistrat e nënpërfituesve. Përfituesi i grantit do të përfshijë paragrafët (a), (b), (d), (e), (g), (h) dhe (i) të kësaj dispozite në të gjitha nënmarrëveshjet me organizata joamerikane, të cilat plotësojnë pragun 300.000\$ të paragrafit (c) të kësaj dispozite. Nënmarrëveshjet me organizatat joamerikane, të cilat nuk plotësojnë pragun e 300.000\$, duhet që minimalisht të përfshijnë paragrafët (h) dhe (i) të kësaj dispozite. Nënmarrëveshjet me organizatat amerikane do të deklarojnë se organizata amerikane u nënshtrohet kërkesave të auditimit të përfshira në OMB, qarkorja A-133.

Seksioni B.6 Plotësimi i informacionit. Përfituesi i grantit konfirmon:

a) që faktet dhe rrethanat, për të cilat ai ka informuar USAID-in ose që ka realizuar informimin e USAID-it në vazhden e arritjes së një marrëveshjeje me USAID-in për marrëveshjen, janë të sakta dhe të plota dhe përfshijnë të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme te

marrëveshja dhe përmbushja e përgjegjësive sipas kësaj marrëveshjeje; dhe

b) që ai do të informojë USAID-in në kohën e duhur për çdo fakt dhe rrethanë pasuese që mund të ndikojë në masë të konsiderueshme ose që mund të ekzistojë besimi se mund të ndikojë te marrëveshja ose përmbushja e përgjegjësive sipas kësaj marrëveshjeje.

Seksioni B.7 Pagesa të tjera. Përfituesi i grantit konfirmon që asnjë pagesë nuk është marrë ose nuk do të merret nga asnjë punonjës i Përfituesit të grantit në lidhje me prokurimin e mallrave ose shërbimeve të financuara sipas marrëveshjes, përveç tarifave, taksave ose pagesave të ngjashme të vendosura në mënyrë të ligjshme në vendin e Përfituesit të grantit.

Seksioni B.8 Informacioni dhe identifikimi. Përfituesi i grantit i bën marrëveshjes publicitet të përshtatshëm si një program për të cilin kanë kontribuar Shtetet e Bashkuara, identifikon vendet e aktiviteteve të marrëveshjes dhe mallrat e financuara nga USAID-i, sipas përshkrimit në dokumentet e zbatimit.

Neni C: Dispozitat e prokurimit

Seksioni C.1 Burimi dhe kombësia

a) Disbursimet (pagesat) do të përdoren ekskluzivisht për të financuar kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për marrëveshjen në përputhje me 22 CFR 228 dhe që burimi dhe kombësia e të cilave është në vendet e përfshira në Kodin Gjeografik 937, siç ishte në fuqi në kohën e bërjes së porosive ose nënshkrimit të kontratave për këto mallra ose shërbime, përveç rasteve kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim dhe si më poshtë:

1. Kostot e transportit transoqeanik do të financohen sipas marrëveshjes vetëm në anijet nën flamurin e regjistrimit të vendeve të përfshira në Kodin 935. Gjithashtu, shihni seksionin C.6 për përdorimin e anijeve me flamur amerikan.

2. Çdo automjet i financuar sipas marrëveshjes do të jetë prodhim i Shteteve të Bashkuara, me përjashtim kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim.

b) Burimi i dërgimit me rrugë ujore ose ajrore konsiderohet të jetë vendi i anijes ujore ose i avionit të regjistrimit në kohë e dërgimit.

c) Dispozitat në lidhje me mallrat dhe shërbimet e kufizuara dhe të papërshtatshme mund të gjenden në një dokument zbatimi.

d) Transportimi me rrugë ajrore i pronës ose personave të financuar nga kjo marrëveshje, kryhet me transportuesit që kanë certifikimin e Shteteve të Bashkuara, në masën që shërbimet nga këta transportues janë të disponueshme sipas ligjit amerikan për fluturimin. Kjo kërkesë mund të përshkruhet më tej nga USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.2 Data e pranueshmërisë. Asnjë mall ose shërbim nuk mund të financohet sipas kësaj marrëveshjeje nëse është prokuruar në pajtim me porositë ose kontratat e bëra ose të lidhura para datës së kësaj marrëveshjeje, përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim.

Seksioni C.3 Planet, specifikimet dhe kontratat. Në mënyrë që të ketë marrëveshje të ndërsjellë për çështjet e mëposhtme dhe, përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim:

a) Përfituesi i grantit do t'i japë USAID-it pas përgatitjes:

1. Plane, specifikime, afate prokurimi ose ndërtimi, kontrata ose dokumentacion tjetër ndërmjet Përfituesit të grantit dhe palëve të treta, në lidhje me mallrat ose shërbimet që do të financohen sipas marrëveshjes, duke përfshirë dokumentacionin në lidhje me parakualifikimin dhe përzgjedhjen e kontraktorëve dhe me kërkesat e ofertave dhe propozimeve. Gjithashtu, modifikimet materiale në këtë lloj dokumentacioni do t'i jepen USAID-it sapo të përgatiten; dhe

2. Një dokumentacion i tillë do t'i jepet USAID-it pas përgatitjes në lidhje me mallra ose shërbime, të cilat, edhe pse jo të financuara sipas marrëveshjes, konsiderohen nga USAID-i të një rëndësie të veçantë për marrëveshjen. Aspektet e marrëveshjes që përfshijnë çështje sipas këtij nënseksioni (a) (2) do të identifikohen në letrat e zbatimit;

b) Dokumentet që lidhen me parakualifikimin e kontraktorëve, si dhe me kërkesën e ofertave ose propozimeve për mallra dhe shërbime të financuara sipas marrëveshjes, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para lëshimit të tyre dhe kushtet e tyre do të përfshijnë standardet dhe matjet (kontrollet, vlerësimet) e Shteteve të Bashkuara;



c) Kontratat dhe kontraktorët e financuar sipas marrëveshjes për shërbime inxhinierike dhe të tjera profesionale për shërbime ndërtimi dhe për shërbime të tjera të tilla për pajisje apo materiale që mund të specifikohen në letrat e zbatimit, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para ekzekutimit të kontratës. Modifikimet materiale në kontrata të tilla do të miratohen me shkrim nga USAID-i para ekzekutimit; dhe

d) Shoqëritë e konsulencës, të përdorura nga Përfituesi i grantit për marrëveshjen, por jo të financuara sipas marrëveshjes, fushëveprimin e shërbimeve dhe atë të personelit të tyre, të caktuar për aktivitetet e financuara sipas marrëveshjes, ashtu siç USAID-i mund t'i specifikojë, dhe kontraktorët e ndërtimit të përdorur nga Përfituesi i grantit për marrëveshjen, por jo të financuara sipas marrëveshjes, do të jenë të pranueshme për USAID-in.

Seksioni C.4 Çmimi i arsyeshëm. Nuk tejkalohet çmimi i arsyeshëm për asnjë nga mallrat ose shërbimet e financuara, plotësisht ose pjesërisht, sipas kësaj marrëveshjeje. Këta artikuj prokurohen mbi një bazë të drejtë dhe, në masën më të gjerë të mundshme konkurruese.

Seksioni C.5 Njoftimi i furnitorëve potencialë. Për t'u mundësuar të gjitha firmave të Shteteve të Bashkuara pjesëmarrjen në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve që financohen sipas marrëveshjes, Përfituesi i grantit i jep USAID-it për këtë qëllim atë informacion dhe në atë kohë që USAID-i mund ta kërkojë në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.6 Transporti

a) Përveç kërkesave të seksionit C.1 (a), kostoja e transportit ujor ose ajror dhe shërbimet përkatëse të dorëzimit, nuk mund të financohen sipas marrëveshjes, nëse shpenzimet janë për transportin sipas një kontrate transporti ujor ose ajror për të cilin nuk është marrë aprovimi i USAID-it.

b) Përveç kur USAID-i përcakton që anijet ujore tregtare me flamur të Shteteve të Bashkuara nuk janë të disponueshme me tarifa të drejta dhe të arsyeshme për këto anije ose kur bie dakord me shkrim:

1. të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e tonazhit bruto të të gjitha mallrave (të llogaritura veçmas për transportuesit për mall rifuxho, linjat e artikujve të ngurtë dhe cisternat), të financuara nga USAID-i, që mund të transportohen në anije ujore, do të transportohen në anijet në pronësi private me flamur të Shteteve të Bashkuara; dhe

2. të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e të ardhurave bruto nga ngarkesat të gjeneruara nga të gjitha dërgesat e financuara nga USAID-i dhe që transportohen në territorin e Përfituesit të grantit me linja për artikuj të ngurtë, u paguhen anijeve tregtare, në pronësi private, që kanë flamurin e Shteteve të Bashkuara ose në interes të tyre. Pajtueshmëria me kërkesat 1 dhe 2 të këtij nënseksioni duhet të arrihet në lidhje me mallrat e transportuara nga portet e SHBA-së edhe për mallrat e transportuara nga portet jo të SHBA-së, të llogaritura veçmas.

Seksioni C.7 Siguracioni

a) Sigurimi detar për mallrat e financuara nga USAID-i, të cilat duhet të transportohen në territorin e Përfituesit të grantit mund të financohet si kosto e shkëmbimit të huaj sipas kësaj marrëveshjeje, me kusht që:

1. ky sigurim të jepet si norma më e leverdisshme konkurruese;

2. ky sigurim të jepet në një vend që është i autorizuar sipas seksionit C.1 (a); dhe

3. pretendimet sipas tij janë të pagueshme në dollarë amerikanë ose në një monedhë lirisht të këmbyeshme, përveç kur USAID-i bie dakord ndryshe me shkrim.

Nëse Përfituesi i grantit (ose qeveria e Përfituesit të grantit) bën dallime me ligj, dekret, rregull, rregullore ose praktikë në lidhje me prokurimin e financuar nga USAID-i ndaj një shoqërie të sigurimit detar të autorizuar që të kryejë biznes në një shtet të Shteteve të Bashkuara, të gjitha mallrat e dërguara në territorin e Përfituesit të grantit, të financuara nga USAID-i sigurohen kundër risqeve detare dhe ky sigurim lidhet në Shtetet e Bashkuara me një ose disa shoqëri të autorizuar që të kryejnë biznes sigurimi detar në Shtetet e Bashkuara.

b) Përveç kur USAID-i bie dakord ndryshe me shkrim, Përfituesi i grantit siguron ose merr masa për sigurimin e mallrave të financuara sipas marrëveshjes të importuara për marrëveshjen kundrejt risqeve para kalimit të tyre në pikën e përdorimit sipas marrëveshjes; ky sigurim lidhet në pajtim me

termat dhe kushtet sipas praktikave të qëndrueshme tregtare dhe siguron vlerën e plotë të mallrave. Çdo zhdëmtim i marrë nga Përfituesi i grantit, sipas këtij sigurimi, përdoret për të zëvendësuar ose riparuar çdo dëm material ose çdo humbje të mallrave, të siguruara ose që përdoret për të rimbursuar Përfituesin e grantit për zëvendësimin ose riparimin e këtyre mallrave. Çdo zëvendësim i tillë është me burim dhe origjinë në vendet e renditura në Kodin Gjeografik 935 të USAID-it, që është në fuqi në momentin e zëvendësimit dhe, përveç kur palët bien dakord me shkrim, i nënshtrohet dispozitave të marrëveshjes.

Seksioni C.8 Pasuria që tepron në pronësi të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Përfituesi i grantit bie dakord që nëse është e mundur duhet të përdoret pasuria personale, që tepron në pronësi të qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në vend të artikujve të tjerë të financuar sipas marrëveshjes. Fondet sipas marrëveshjes mund të përdoren për të financuar koston e përfitimit të kësaj pasurie.

Neni D: Disbursimet

Seksioni D.1 Disbursimet (pagesat). Disbursimet do të bëhen me anë të mjeteve të tilla që palët mund të bien dakord me shkrim.

Seksioni D.2 Kursi i këmbimit. Nëse fondet e dhëna sipas kësaj marrëveshjeje prezantohen në vendin bashkëpunues nga USAID-i ose një agjenci publike ose private për qëllimet e përmbushjes së detyrimeve të USAID-it, Përfituesi i grantit merr ato masa që mund të jenë të nevojshme në mënyrë që këto fonde të mund të konvertohen në monedhën vendase me normën më të lartë të këmbimit, që, në momentin e kryerjes së këmbimit, nuk është e paligjshme në vendin e përfituesit e grantit te ndonjë person për ndonjë qëllim të caktuar.

Neni E: Zgjidhja; mjetet ligjore

Seksioni E.1 Pezullimi dhe zgjidhja

a) Secila palë mund të zgjidhë këtë marrëveshje në tërësinë e saj, duke i bërë palës tjetër një njoftim paraprak me shkrim tridhjetë (30) ditë para. USAID-i mund të zgjidhë këtë marrëveshje pjesërisht, duke i bërë Përfituesit të grantit një njoftim me shkrim tridhjetë (30) ditë para dhe të pezullojë këtë marrëveshje plotësisht ose pjesërisht, duke i bërë Përfituesit të grantit një njoftim me shkrim. Përveç kësaj, USAID-i mund ta prishë këtë marrëveshje plotësisht ose pjesërisht, duke i bërë njoftim me shkrim Përfituesit të grantit, nëse: i) përfituesi i grantit nuk përmbush ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje; ii) ndodh një ngjarje që USAID-i vendos se e bën të pamundur arritjen e objektivit ose rezultateve të marrëveshjes ose programit të asistencës, ose që Përfituesi i grantit do të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje; ose iii) çdo disbursim ose përdorim fondesh në mënyrën e parashikuar do të ishte shkelje e legjislacionit që rregullon USAID-in, që është në fuqi në atë kohë ose më vonë;

b) Përveç pagesës që palët janë të detyruara të bëjnë në pajtim me detyrimet e paanulueshme të lidhura me palët e treta para pezullimit ose zgjidhjes, pezullimi ose zgjidhja e të tërë kësaj marrëveshjeje ose pjesë të saj pezullon (për periudhën e pezullimit) ose pushon, sipas rastit, çdo detyrim të palëve për dhënien e burimeve financiare ose të tjera të marrëveshjes ose për pjesën e pezulluar ose të pushuar të marrëveshjes, sipas rastit. Çdo pjesë e kësaj marrëveshjeje, që nuk pezullohet ose pushohet, mbetet në fuqi të plotë.

c) Përveç kësaj, pas pezullimit ose zgjidhjes së plotë ose të pjesshme, USAID-i, me shpenzimet e tij, mund të udhëzojë që titulli për mallrat e financuara sipas marrëveshjes ose sipas pjesës së zbatueshme të marrëveshjes, t'i transferohet USAID-it nëse mallrat janë në një gjendje të mund të dorëzohen.

Seksioni E.2 Shlyerjet. Çdo shlyerje e bërë USAID-it nga një kontraktor, furnitor, bankë ose palë e tretë në lidhje me mallrat ose shërbimet e financuara sipas marrëveshjes, shlyerje, e cila lidhet me një çmim të paarsyeshëm ose faturim të gabuar të mallrave ose shërbimeve, ose për mallrat që nuk përputhen me specifikimet ose shërbimet që kanë qenë të papërshtatshme: A) ofrohet fillimisht për marrëveshjen, në masën e justifikuar; dhe B) pjesa e mbetur, sipas rastit, përdoret për të ulur shumën e grantit.

Seksioni E.3 Mosheqja dorë nga mjetet ligjore. Asnjë vonesë në ushtrimin e një të drejte ose mjeti ligjor që i takon një pale në lidhje me financimin sipas kësaj marrëveshjeje, nuk interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet ligjor.



Seksioni E.4 Transferimi. Përfituesi i grantit, me kërkesë, bie dakord të ekzekutojë një transferim tek USAID-i të çdo motivi padie që mund t'i lindë Përfituesit të grantit në lidhje me ose që rrjedh nga përmbushja kontraktuale ose shkelja e përmbushjes nga një palë të një kontrate të drejtpërdrejtë me dollarë amerikanë që USAID-i ka financuar plotësisht ose pjesërisht nga fondet e dhëna nga USAID-i sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni F: Të ndryshme

Seksioni F.1 Promovimi i investimeve

a) Përveç kur është parashikuar specifikisht nga kjo marrëveshje ose kur është autorizuar ndryshe nga USAID-i me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e dhënë nuk mund të përdoret për ndonjë aktivitet që lidhet me promovimin e investimit në një vend të huaj.

b) Në rast se Përfituesit të grantit i kërkohet të ofrojë asistencë në fushën e mësipërme ose kërkon sqarim nga USAID-i, nëse aktiviteti do të ishte në pajtim me kufizimin e përcaktuar më sipër, Përfituesi i grantit duhet të njoftojë USAID-in dhe të paraqesë një përkrahje të hollësishme të aktivitetit të propozuar. Përfituesi i grantit nuk duhet të vazhdojë me aktivitetin derisa të këshillohet nga USAID-i që mund ta bëjë këtë.

c) Përfituesit i grantit duhet të sigurojë që punonjësit dhe nënkontraktorët dhe nënpërfituesit që ofrojnë shërbime për promovimin e investimit të vihen në dijeni për kufizimet e parashikuara në këtë klauzolë dhe duhet ta përfshijnë këtë klauzolë në të gjitha nënkontratat ose nënarrëveshjet e lidhura.

Seksioni F.2 Planifikimi familjar vullnetar

Palët bien dakord që të gjitha fondet e USAID-it të dhëna sipas kësaj marrëveshjeje, të përdoren në pajtim me politikën dhe kërkesat ligjore të zbatueshme të Shteteve të Bashkuara në lidhje me projektet për planifikimin familjar vullnetar dhe asnjë nga fondet e USAID-it, të dhëna sipas kësaj marrëveshjeje, apo mallrat ose shërbimet e financuara nga këto fonde, nuk mund të përdoret për:

a) kryerjen e abortit si një metodë e planifikimit familjar ose për të motivuar ose detyruar një person për të ushtruar aborte;

b) kryerjen e sterilizimeve jovullnetare, si një metodë e planifikimit familjar ose për të detyruar apo ofruar stimul financiar një personi për t'iu nënshtruar sterilizimit; ose

c) një kërkim biomjekësor që lidhet, plotësisht ose pjesërisht, me metodat ose kryerjen e aborteve ose sterilizimeve të pavullnetshme, si një metodë planifikimi familjar.

d) USAID-i lëshon dokumente zbatimi që përshkruajnë në mënyrë më të plotë kërkesat e këtij seksioni.

Seksioni F.3 Ndalimi i asistencës për trafikantët e drogës

a) USAID-i rezervon të drejtën të prishë këtë marrëveshje ose të marrë masa të tjera të përshtatshme, nëse Përfituesi i grantit ose një individ kryesor i Përfituesit të grantit konstatohet të jetë dënuar për një veprë penale të lëndëve narkotike ose të jetë përfshirë në trafikimin e drogës, sipas përkufizimit në 22 CFR pjesa 140.

b) USAID-i rezervon të drejtën të ndërpresë asistencën ose të marrë masa të tjera të përshtatshme në lidhje me çdo pjesëmarrës, të aprovuar nga USAID-i, që konstatohet të jetë dënuar për një veprë penale të lëndëve narkotike ose të jetë përfshirë në trafikimin e drogës sipas përkufizimit në 22 CFR pjesa 140.

Seksioni F.4 Të drejtat e punëtorëve. Përveç kur është parashikuar specifikisht nga kjo marrëveshje ose kur është autorizuar ndryshe nga USAID-i me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e dhënë nuk mund të përdoret për ndonjë aktivitet që lidhet me të drejtat e punëtorëve në një vend të huaj.

Seksioni F.5 Ndalimi i financimit të delegacioneve qeveritare të huaja në Konferenca Ndërkombëtare. Përveç kur USAID-i bie dakord ndryshe me shkrim, fondet e dhëna sipas kësaj marrëveshjeje që jepen nga USAID-i nga ligji për pjesët për operacionet e huaja, financimin e eksportit dhe programet përkatëse për çdo vit fiskal të qeverisë së SHBA-së pas vitit fiskal 1999, nuk mund të përdoren për të financuar udhëtimin, dietat, shpenzimet e hotelit, ushqimin, tarifën e konferencave ose kosto të tjera të konferencave për ndonjë anëtar të delegacionit të qeverisë së huaj në një konferencë ndërkombëtare, të sponsorizuar nga një organizatë publike ndërkombëtare. Ky kufizim mund të përshkruhet më tej nga USAID-i në dokumentet e zbatimit.

VENDIM
Nr. 790, datë 14.11.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN N. 578, DATË 29.8.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË KALIMIT NË PRONËSI TË
OBORREVE NË PËRDORIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “b” e pikës 9 të vendimit nr. 578, datë 29.8.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Verifikimi i kushteve të parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga punonjësit e AKKP-së.

Nëse gjatë inspektimit në terren rezulton se brenda apo në lidhje funksionale me sipërfaqen e oborrit në përdorim, gjenden vetëm ndërtime informale, AKKP-ja procedon menjëherë me mospranimin e kërkesës për tjetërsim, duke njoftuar kërkuesin, me vendim të arsyetuar me shkrim, për mosplotësimin e kushtit të parashikuar në shkronjën “ç” të pikës 5 dhe në pikën 6 të këtij vendimi.”.

2. Kërkesat e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për të cilat ende nuk është dhënë vendim nga AKKP-ja, vazhdojnë të shqyrtohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 792, datë 14.11.2012

**PËR ULJEN E TARIFËS SË QIRASË TË DISA AMBIENTEVE TË PALLATIT TË
KONGRESEVE, ME RASTIN E HAPJES SË PANAIRIT TË 15-TË TË LIBRIT “TIRANA 2012”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Uljen në masën 50% të tarifave të qirasë të disa ambienteve të Pallatit të Kongreseve, me rastin e hapjes së Panairit të 15-të të Librit “Tirana 2012”.

2. Ulja e tarifave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të jetë vetëm për datat 14-18 nëntor 2012, për zhvillimin e Panairit të 15-të të Librit “Tirana 2012”.

3. Në zbatim të këtij vendimi, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të lidhë marrëveshjet e qirasë me subjektet pjesëmarrëse në këtë panair.



4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 796, datë 14.11.2012

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 15 BASHKI DHE 23 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, përkatësisht, 15 bashki dhe 23 komuna, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Fondi, në vlerën 44 128 447 lekë (dyzet e katër milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) lekë përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2012.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr 1

Nr.	Emri i NJQV-se	Vlera (ne leke)
1	Bashkia Korce	146,072
2	Bashkia Corovode	831,000
3	Bashkia Belsh	811,123
4	Bashkia Ura Vajgurore	675,490
5	Bashkia Gramsh	4,518,323
6	Bashkia Pogradec	1,651,500
7	Bashkia Prrenjas	22,625
8	Bashkia Lushnje	7,047,640
9	Bashkia Polican	514,500
10	Bashkia Bilisht	450,500
11	Bashkia Ballsh	1,129,130
12	Bashkia Roskovec	576,000
13	Bashkia Lushnje	7,047,640
14	Bashkia Sukth	438,417
15	Bashkia Kelcyre	1,491,500
16	Komuna Perondi	1,138,212
17	Komuna Otlak	480,690
18	Komuna Allkaj	449,000
19	Komuna Cukalat	52,500
20	Komuna Sinje	76,800
21	Komuna Vertop	308,750
22	Komuna Mollas (Elbasan)	763,370
23	Komuna Kozare	1,581,250
24	Komuna Maminas	321,000
25	Komuna Cerrave	195,976
26	Komuna Paskuqan	4,168,090
27	Komuna Lumas	768,750
28	Komuna Dermenas	104,275
29	Komuna Hajmel	35,916
30	Komuna Qender- Fier	517,749
31	Komuna Kutalli	553,500
32	Komuna Mollas (Kolonje)	24,472
33	Komuna Katundi i Ri	1,760,000
34	Komuna Levan	1,181,792
35	Komuna Berzhite	1,366,000
36	Komuna Bucimas	145,895
37	Komuna Finiq	760,000
38	Komuna Dardhas	23,000
Shuma		44,128,447



VENDIM
Nr. 800, datë 14.11.2012

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 41, DATË 11.1.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET BAZË, SEKTORËT QË DO TË MBËSHTETEN DHE MASËN E PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR VITIN 2012", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" dhe të nenit 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 41, datë 11.1.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në kreun VII, fjalët "... 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë ..." zëvendësohen me "... 100 000 (njëqind mijë) lekë ...".

2. Pas kreut VII shtohet kreu VII/1 me këtë përmbajtje:

"VII/1. Shuma prej 69 900 000 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lekësh do të kalojë për të financuar skemat kombëtare të mbështetjes së fermerëve në prodhimin bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 25, datë 16.11.2012

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 26.01.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË DUHUR PËR SHTYPJEN E BILETAVE, SHPËRNDARJEN DHE KONTROLLIN E HEDHJES SË TYRE NË PËRDORIM", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 13 pika 2 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 4 ndryshon si më poshtë:

"4. Biletat e lojërave të fatit shtypen në Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë. Kur Shtypshkronja e Letrave me Vlerë nuk ka kapacitet teknologjik për shtypjen e këtyre biletave, ato mund të shtypen në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit."

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 4.1 dhe 4.2 me këtë përmbajtje:

"4.1 Operatorët e miratuar për zhvillim aktiviteti lojërash fati, i dërgojnë paraprakisht Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë (Sh.L.V-së) kërkesë për shtypjen e biletave të lojës së fatit, e cila do t'i propozohet për miratim Ministrit të Financave. Me marrjen e kërkesës për shtypjen e biletave të lojërave të fatit nga operatori, Shtypshkronja e Letrave me Vlerë vlerëson nëse:

a) Ka apo jo kapacitetin teknik për shtypjen e kësaj bilete në formën dhe specifikimet e kërkuara nga operatori.

b) Negocion me operatorin, duke i propozuar këtij të fundit ndryshimet e nevojshme, me qëllim bërjen të mundur të shtypjes së biletës pranë këtij institucioni, sipas mundësive të këtij të fundit.

c) Nëse edhe pas negocimit operatori nuk bie dakord për ndryshimet e propozuara dhe SHLV dyshon se nuk ka kapacitetin e duhur teknologjik të shtypjes së biletave të kërkuara, mblidhet bordi drejtues i SHLV-së, i cili shqyrton dhe analizon kapacitetet teknike. Nëse bordi drejtues konstaton gjithashtu që SHLV nuk ka kapacitetet teknike për shtypjen e këtyre biletave dhe argumenton pamundësinë e kthimit ekonomik nëse do të investohej për blerjen e teknologjisë së munguar për këto raste, shprehet me vendim.

ç) Vendimi i bordit drejtues për pamundësinë e ofrimit të shërbimit, i komunikohet operatorit kërkuar dhe Njesisë së Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, i shoqëruar ky me dokumentacionin justifikues që ka çuar në marrjen e këtij vendimi. Në vijim, operatori mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për shtypjen e këtyre biletave në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit, dhe vë në dijeni institucionin mbikëqyrës të aktivitetit të tij (NJMLF-në).”

d) NJMLF-ja, pasi merr dijeni për vendimin e SHLV-së, kërkesën e operatorit dhe dokumentacionin e parashikuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, së bashku me opinionin e tij të mirargumentuar, i dërgon për miratim Ministrin të Financave biletën e propozuar nga operatori, me të njëjtat specifikime, detaje teknike dhe format, si ato të dërguara nga vetë operatori i SHLV-së.”

4.2 “Në zbatim të pikës 4.1, Njësia e Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit merr në disponim nga operatori dhe Shtypshkronja e Letrave me Vlerë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për të garantuar shmangien e abuzimeve të mundshme.”.

3. Pika 5 e udhëzimit ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Në kontratën e lidhur me Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë apo me shklypshkronja brenda ose jashtë vendit, do të përcaktohet data e fillimit të shtypjes së biletave, data e dorëzimit të biletave, sasia në copë e biletave, numri serial i biletave, çmimi i shtypjes së biletave, specifikimet teknike të biletave dhe vendosja e elementeve të sigurisë në biletë.”.

4. Pas pikës 7, shtohet pika 7.1 me këtë përmbajtje:

“7.1. Për biletat të cilat nuk shtypen pranë SHLV-së, ndiqet kjo procedurë:

a) Vetëm shoqëritë e licencuara për organizim të lojrave të fatit, kanë të drejtën të lidhin kontrata për prodhim biletash të lojrave të fatit me shtypshkronjën prodhuese të biletave të tyre, të importojnë dhe të hedhin në treg bileta të lojrave të fatit.

b) Në rast se biletat janë shtypur jashtë vendit, në deklaratën e zhdoganimit duhet të jetë e përfshirë: sasia në copë e biletave dhe numri serial i tyre, sipas çmimeve përkatëse. Një kopje e deklaratës së zhdoganimit i dërgohet NJMLF-së nga dega doganore përkatëse dhe gjithashtu, operatori i lojrave të fatit, përpara hedhjes në treg të biletave, i dërgon një kopje të deklaratës doganore, NJMLF-së. Të gjitha procedurat e tjera janë të njëjta sikur biletat të ishin shtypur pranë SHLV-së.

c) Në rast se biletat shtypen në shtypshkronja brenda vendit, veprojnë të njëjtat dispozita si ato të shtypura pranë SHLV-së.”.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



VENDIM
Nr. 3, datë 20.11.2012

PËR PËRCAKTIMIN E SHTETEVE, ME NIVEL TË MJAFTUESHËM TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Mbështetur në pikën 1 të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar dhe vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.9.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”,

VENDOSA:

1. Shtetet që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, janë:
 - a) shtetet anëtare të Bashkimit Europian;
 - b) shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Europiane;
 - c) palët e konventës nr. 108 të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, si dhe të protokollit shtesë të saj të vitit 1981;
 - ç) shtetet ku mund të transferohen të dhënat personale, sipas një vendimi të Komisionit të Bashkimit Europian.
2. Shtetet, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale evidentohen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës për përditësimin e listës së shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në aneksin nr. 1. Lista e përditësuar publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit të Komisionerit në internet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

ANEKSI 1

Për të gjithë zbatuesit e vendimit nr. 3, datë 20.11.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, detajohet më poshtë përmbajtja e çdo pike të tij.

- Në përputhje me pikën 1(a) listohen “shtetet anëtare të Bashkimit Europian”:

Austri	Gjermani	Holandë
Belgjikë	Greqi	Poloni
Bullgari	Hungari	Portugali
Qipro	Irlandë	Rumani
Republika Çeke	Itali	Slovaki
Danimarkë	Letoni	Sloveni
Estoni	Lituani	Spanjë
Finlandë	Luksenburg	Suedi
Francë	Maltë	Britani e Madhe

- Në përputhje me pikën 1 (b) listohen “shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Europiane”:

Islandë
Litenshtejn
Norvegji
Zvicër

- Në përputhje me pikën 1 (c) listohen “shtetet palë të Konventës nr. 108 të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, si dhe të protokollit shtesë të saj të vitit 1981:

Shqipëri	Kroaci	Gjermani
Andora	Republika Çeke	Greqi
Austri	Qipro	Hungari
Belgjikë	Danimarkë	Islandë
Bosnjë-Hercegovina	Estoni	Irlandë
Bullgari	Finlandë	Itali
Litenshtein	Francë	Letoni
Lituani	Portugali	Republika e Maqedonisë
Luksemburg	Rumani	Britani e Madhe
Maltë	Slovaki	Mali i Zi
Holandë	Sloveni	Monako
Norvegji	Spanjë	Serbi
Poloni	Suedi	Ukrainë
	Zvicër	

Këto shtete, në zbatim të këtyre akteve, kanë ngritur autoritetin mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Në përputhje me pikën 1 (ç), listohen “shtetet, në të cilat mund të transferohen të dhënat personale sipas një vendimi të Komisionit të Bashkimit Europian”.

1. Argjentinë

Vendim i Komisionit C(2003) 1731 i datës 30 qershor 2003 - OJ L 168, 5.7.2003.

(Opinion 4/2002 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në Argjentinë, dokumenti nr. grupi i punës 63).

2. Kanada

Vendim i Komisionit 2002/2/EC i datës 20.12.2001 për mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave nga ligji kanadez “Për mbrojtjen e informacionit personal dhe dokumenteve elektronike” - O.J. L 2/13, 4.1.2002.

(Opinion 2/2001 për mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave nga mbrojtja e informacionit personal kanadez dhe dokumenteve elektronike akti, dokumenti nr. grupi i punës 39).

3. Guernsey

Vendim i Komisionit i datës 21 nëntor 2003 për mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave në Guernsey.

(Opinion 5/2003 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave Guernsey, dokumenti nr. grupi i punës 79).

4. Isle of Man

Vendim i Komisionit 2004/411/EC, datë 28.4.2004 për mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave në Isle of Man. (Opinion 6/2003 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në Isle of Man, dokumenti nr. grupi i punës 82).

5. Jersey

Vendim i Komisionit, i datës 8 maj 2008 sipas direktivës 95/46/EC i Parlamentit Europian dhe Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave në Jersey (i njoftuar sipas dokumentit numër C(2008) 1746) - OJ L 138, 28.5.2008.

(Opinion 8/2007 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave në Jersey, dokumenti nr. grupi i punës 141).

6. Zvicër (gjithashtu si anëtar i ZEE-së)

Vendim i Komisionit, i datës 26 korrik 2000 sipas direktivës 95/46/EC i Parlamentit Europian dhe Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave të dhënë në Zvicër.

(Opinion 5/1999 për nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale në Zvicër, dokumenti nr. grupi i punës 22).



7. Ishujt Faroe

Vendim i Komisionit i datës 5 mars 2010 sipas direktivës 95/46/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuar në aktin e ishujve Faroe për përpunimin e të dhënave personale; dokumenti C(2010)1130.

8. Izrael

Vendim i Komisionit 2011/61/EU i datës 31 janar 2011 sipas direktivës 95/46/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale nga shteti i Izraelit në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.

(Opinion 6/2009 për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale në Izrael të nenit 29 WP, dokumenti nr. grupi i punës 166).

- Transferimi i të dhënave personale mund t'i bëhet një marrësi të vendosur në territorin e SHBA-së, i cili është anëtar i programit porti i sigurt (Safe Harbour).

UDHËZIM

Nr. 23, datë 20.11 2012

PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

Mbështetur në shkronjën “c”, pika 1 e nenit 30 dhe shkronjën “f”, pika 1 e nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004, të ndryshuar “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZON:

KREU I

OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Ky udhëzim përcakton rregullat kryesore për mbrojtjen e të dhënave në sektorin e shëndetësisë.

2. Ky udhëzim zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët veprojnë në sistemin e kujdesit shëndetësor, si dhe organet e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen ose kontrollin e kujdesit shëndetësor, dhe për përpunuesit e të dhënave që veprojnë në emër të tyre, ndër të tjera:

a) Ministrinë e Shëndetësisë;

b) institucionet shëndetësore, publike dhe private;

c) mjekët, përfshirë edhe mjekët e përgjithshëm;

ç) farmacitë;

d) institucionet e sigurimeve shëndetësore;

dh) kontrolluesin e “sistemeve të informacionit shëndetësor”, Institutin e Shëndetit Publik;

e) shërbimin e luftës kundër sëmundjeve infektive;

ë) drejtorinë e higjienës dhe epidemiologjisë dhe drejtorinë rajonale të shëndetit publik;

f) qendrat e transplantit dhe qendra për koordinimin e transplantit;

g) qendrat e transfuzionit të gjakut;

gj) organizatat që përpunojnë të dhëna personale në emër të ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;

h) organizatat për mbikëqyrjen dhe kontrollin e ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

3. Fusha e zbatimit e këtij udhëzimi përfshin:

a) përpunimin e të dhënave shëndetësore nga persona që përcaktohen në pikën 2 të këtij udhëzimi;

b) mbikëqyrjen me anë të sistemit të videosurvejimit të vënë në funksion nga persona të përcaktuar në pikën 2 shkronjën “b” dhe “c” të këtij udhëzimi.

KREU II REGJISTRIMI I TË DHËNAVE SHËNDETËSORE PËR QËLLIME TË KUJDESIT NDAJ PACIENTIT NJOFTIMI

1. Çdo pjesë e informacionit në lidhje me personin fizik që i referohet shëndetit të tij (më poshtë “të dhëna shëndetësore”) mund të përpunohet për qëllime parandaluese, të shërbimit diagnostikues, të shërbimit të kujdesit shëndetësor, nëse të dhënat janë përdorur nga profesionistët e shëndetit apo persona të tjerë që i nënshtrohen detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit.

2. Vetëm të dhënat shëndetësore që janë të nevojshme dhe të rëndësishme për parandalimin, diagnostikimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor duhet të regjistrohen. Tërësia e të dhënave që janë të nevojshme për trajtim mjekësor përcaktohet rast pas rasti nga profesionistët e shëndetësisë.

3. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna shëndetësore, informon subjektin e të dhënave për objektin dhe qëllimin për të cilin të dhënat personale janë duke u përpunuar, personin që do të përpunojë të dhënat, mënyrat e përpunimit. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave mbi të drejtën për akses dhe të drejtën për të korrigjuar të dhënat në lidhje me të.

4. Ofruesit e kujdesit shëndetësor duhet të njoftojnë Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave për përpunimin e të dhënave personale. Njoftimi përmban:

- a) emrin dhe adresën e kontrolluesit;
- b) qëllimet e përpunimit të të dhënave personale;
- c) kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe kategoritë e të dhënave personale;
- d) marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave personale;
- e) propozime për transferime ndërkombëtare që kontrolluesi synon të kryejë;
- f) një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale.

Përmbajtja dhe vërtetësia e njoftimit kontrollohen rregullisht nga personi i caktuar nga drejtuesi i institucionit, siç përcaktohet në kreun VI.

KREU III RUAJTJA E TË DHËNAVE SHËNDETËSORE

1. Ofruesi i kujdesit shëndetësor mban një dosje shëndetësore për pacientin, duke përfshirë të gjitha të dhënat shëndetësore që lidhen me të.

2. Dosjet shëndetësore mbahen për 30 vjet nga regjistrimi i të dhënave të fundit të përfshira në të. Raportet e hedhjes së tyre mbahen për 50 vjet. Regjistrimet e bëra, duke përdorur metodat diagnostikuese të imazhit mbahen për 10 vjet. Pas afatit të caktuar, bëhet një vlerësim nëse ruajtja e mëtejshme e tyre është e nevojshme për qëllime shkencore, përndryshe, të dhënat do të fshihen. Nëse është e nevojshme ruajtja e mëtejshme për qëllime shkencore, të dhënat do të transmetohen në arkivin përkatës të shtetit.

3. Farmacitë mbajnë recetat për 2 vjet, recetat për lëndët narkotike dhe psikotrope për 3 vjet dhe 5 vjet për barnat helme me veprim të fortë.

4. Gjatë kohës së ruajtjes, lexueshmëria dhe integriteti i të dhënave shëndetësore ruhen duke përdorur masa teknike. Korrigjimi i të dhënave të rreme ose të shkruara gabim kryhet në atë mënyrë që këto të dhëna të mos fshihen edhe pas korrigjimit.

5. Ofruesi i kujdesit shëndetësor siguron një nivel sigurie të të dhënave që reflekton natyrën e ndjeshme të të dhënave shëndetësore të përpunuara. Të dhënat duhet të mbrohen nga aksesit i paautorizuar, ndryshimi, transferimi, transmetimi, përhapja, fshirja, shkatërrimi ose dëmtimi aksidental.

6. Në rast përdorimi të pajisjeve elektronike për ruajtjen e të dhënave elektronike, ofruesi i kujdesit shëndetësor zbaton masa sigurie të cilat:

- a) parandalojnë hyrjen dhe aksesin e paautorizuar në të dhënat nga persona të paautorizuar;



- b) parandalojnë humbjen aksidentale ose modifikimin e të dhënave;
- c) parandalojnë humbjen e të dhënave edhe në rast mosfunksionimi të sistemeve IT dhe sigurojnë disponueshmërinë e të dhënave gjatë periudhës së ruajtjes, të përcaktuar në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe në këtë udhëzim.

KREU IV PRIVATËSIA E PACIENTËVE, AKSESI I PALËVE TË TRETË

Privatësia e pacientëve, trajnimi i stafit mjekësor

1. Përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj, asnjë person nuk do të jetë i pranishëm gjatë trajtimit mjekësor, përveç mjekut dhe stafit mjekësor që kryen trajtimin dhe personat, prania e të cilëve është miratuar nga ana e pacientit dhe nëse kjo është e pashmangshme, pacientë të tjerë, kur rrethanat nuk e bëjnë të mundur trajtimin në një hapësirë të veçantë.

2. Për qëllime të trajnimit të profesionistëve shëndetësorë, studentëve universitarë, të shkollave të larta ose të mesme të regjistruar në studime mjekësore apo për trajnime profesionale mjekësore mund të jenë të pranishëm, vetëm nëse pacienti apo përfaqësuesi ligjor ka dhënë pëlqimin e tij.

3. Te ofruesit e shërbimeve shëndetësore që janë caktuar për trajnimin e stafit mjekësor, pëlqimi i pacientit ose i përfaqësuesit ligjor nuk është i nevojshëm për praninë e personave të përcaktuar në pikën 1, nëse kjo gjë autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik, nën masa të përshtatshme mbrojtëse.

Zhvillimi i materialeve trajnuese që përdoren për demonstrime gjatë trajnimeve dhe kërkimeve mjekësore

4. Materialet trajnuese që përdoren për demonstrime gjatë trajnimeve mjekësore dhe shkencore, imazheve, videoregjistrime ose regjistrime zanore mund të përdoren me kusht që të dhënat shëndetësore të anonimizohen.

5. Materialet e përdorura për demonstrime gjatë trajnimeve mjekësore dhe shkencore, imazhet, videoregjistrimet ose regjistrimet zanore, përfshirë të dhënat personale, mund të përgatiten për qëllim të zhvillimit të materialeve trajnuese me pëlqimin e pacientit apo të përfaqësuesit ligjor.

6. Tek ofruesit e shërbimeve shëndetësore që janë caktuar për trajnimin e stafit mjekësor, pëlqimi i pacientit ose i përfaqësuesit ligjor nuk është i nevojshëm për regjistrimin e imazheve, regjistrimeve video dhe/ose audio të përcaktuara më lart, nëse ai është i autorizuar nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik, nën masa të përshtatshme mbrojtëse.

Kërkimi shkencor

7. Për qëllime të kërkimeve shkencore¹, studiuesit mund të kenë akses në të dhënat shëndetësore me lejen e drejtorit të ofruesit të shërbimit shëndetësor. Publikimi nuk duhet të përfshijë të dhëna shëndetësore që mund të jenë të lidhura me një person të identifikuar apo të identifikueshëm, por vetëm të dhëna anonime. Gjatë kërkimit, studiuesit nuk kopjojnë të dhënat shëndetësore që nuk janë bërë anonime².

8. Emrat e studiuesve që kanë akses në regjistrime duhet të regjistrohen, së bashku me qëllimin dhe kohën në të cilën i lejohet aksesit. Regjistrimi i aksesit mbahet për 10 vjet dhe pastaj fshihet.

Delegimi i përpunimit (*outsourcing*)

9. Ofruesi i kujdesit shëndetësor mund të kontraktojë përpunues për kryerjen e veprimeve teknike për përpunimin e të dhënave shëndetësore (p.sh. për ruajtjen e sigurt të të dhënave).

10. Në rast kontraktimi të një përpunuesi, duhet të lidhet një kontratë me shkrim ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit, duke përmbushur kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave” të këtij udhëzimi, si dhe udhëzimit nr. 19, datë 3.8.2012.

¹ Qëllime shkencore siç përcaktohet në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave” nënkupton studime dhe hulumtime sistematike, që finalizon zhvillimin e dijeve shkencore në një sektor të caktuar.

² “E dhënë anonime”, siç përcaktohet në nenin 3, pika 3 e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave”, është çdo e dhënë, që në origjinë ose gjatë përpunimit, nuk mund t’i shoqërohet një individ, të identifikuar ose të identifikueshëm”.

11. Përpunuesi ndjek udhëzimet e ofruesit të kujdesit shëndetësor kur përpunimi i të dhënave shëndetësore kryhet në emër të tij. Ai nuk përdor të dhënat për qëllimet e tij, dhe nuk i lejon akses palëve të treta në të dhënat e përpunuara, përveç kur me ligj parashikohet ndryshe.

12. Përpunuesi njofton kontrolluesin në qoftë se synon të kontraktojë përpunues të tjerë (nënpërpunues). Në rast nënpërpunimi, kërkesat në lidhje me përpunuesin, të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në këtë udhëzim, si dhe në udhëzimin nr. 19, datë 3.8.2012 zbatohen edhe për nënpërpunuesin.

13. Ofruesi i kujdesit shëndetësor siguron dhe përcakton në kontratën e bërë me përpunuesin që përpunuesi garanton nivelin e mbrojtjes së të dhënave, siç përcaktohet në kreun III të këtij udhëzimi.

Transmetimi i të dhënave te palë të treta

14. Të dhënat shëndetësore mund të transmetohen te palë të treta, nëse pacienti ka dhënë pëlqimin për transmetimin, nëse kjo është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe nëse subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e tij ose nëse është i autorizuar me ligj.

15. Kërkesa për transmetimin e të dhënave te palë të treta bëhet me shkrim dhe përcakton të dhënat shëndetësore që janë objekt i kërkesës së bashku me qëllimin e kërkesës. Të dhënat e kërkuara duhet të jenë të përshtatshme dhe të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të kërkesës. Në rast se ofruesi i kujdesit shëndetësor vëren se të dhënat e kërkuara nuk janë në përpjesëtim me qëllimin e transmetimit, ai njofton menjëherë Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

16. Të dhënat shëndetësore mund të transmetohen, ndër të tjera, në institucionet e mëposhtme:

- a) te agjencitë për zbatimin e ligjit dhe prokurorë që kryejnë/ndjekin hetime penale;
- b) te gjykatat në procedura penale dhe civile;
- c) te autoritetet që kryejnë procedura në rast kundërvajtje;
- d) te agjencitë kombëtare të sigurisë;
- e) te organet përgjegjëse që kryerjen kontrole për shkelje etike kundër personelit mjekësor;
- f) te institucione të sistemit shëndetësor brenda vendit për kurimin e pacientit, si dhe në Ministrinë e Financave, në rastet kur bëhet mbulim i pjesshëm i shpenzimeve të trajtimit shëndetësor;
- g) te sistemi i informacionit shëndetësor që administrohet nga ISKSH-ja.

17. Kur kryerja e një transmetimi nuk është parashikuar në pikën 16 të këtij kreu ai do të kryhet në përputhje me nenin 7 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe pikën 14 të këtij kreu.

18. Përveç kur është parashikuar ndryshe me ligj, transmetimi i të dhënave shëndetësore regjistrohet së bashku me marrësit e tyre, subjektet e të dhënave në transmetimin e të dhënave, qëllimin dhe datën e transmetimit. Këto të dhëna mbahen për 5 vjet.

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave te palë të treta

19. Të dhënat shëndetësore mund të transferohen në rastet e kurimit të pacientit tek institucione të sistemit të kujdesit shëndetësor në një shtet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

20. Të dhënat shëndetësore mund të transferohen në rastet e kurimit të pacientit tek institucione të sistemit të kujdesit shëndetësor në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale vetëm nëse:

- a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferimin ndërkombëtar;
- b) është i nevojshëm për mbrojtjen e një interesi jetik të subjektit të të dhënave;
- c) me autorizim të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU V

PROCEDURA NË RAST NDALIMI TË AKTIVITETIT, SHKATËRRIMI I PAJISJEVE KU RUHESHIN TË DHËNAT

1. Në qoftë se ofruesi i shërbimit shëndetësor pushon aktivitetin e tij pa pasur një pasues ligjor:
 - të dhënat shëndetësore me vlerë shkencore transmetohen në arkivin përkatës të shtetit;
 - të dhënat e tjera transmetohen tek institucioni i përcaktuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



2. Në rast hedhjeje të kompjuterëve, njësisive *hard disk*, ose të ndonjë pajisjeje tjetër të përdorur për ruajtjen e të dhënave, ato shkatërrohen ose dërgohen për shkatërrim në mënyrë që asnjë e dhënë shëndetësore të mos rikuperohet nga persona të paautorizuar.

KREU VI PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E DREJTUESVE

1. Drejtuesi i ofruesit të shërbimit shëndetësor është përgjegjës për respektimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave. Drejtuesi ka këto detyra:

- a) siguron që veprimet e përpunimit të të dhënave brenda institucionit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë udhëzim;
- b) vendos për fshirjen e të dhënave personale pas mbarimit të afatit të përcaktuar në këtë udhëzim;
- c) siguron që anëtarët e stafit që kanë akses në të dhënat personale kanë trajnimin e duhur në lidhje me rregullat përkatëse;
- d) jep lejen për kërkime shkencore që rregullohen në kreun IV;
- e) nxjerr dhe nënshkruan një rregullore të brendshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;
- f) cakton një person të ngarkuar për çështjet e mbrojtjes së të dhënave, i cili do ta ndihmojë në përmbushjen e detyrave të tij të përcaktuara më sipër.

KREU VII SISTEMI I VIDEOSURVEJIMIT I VËNË NË FUNKSION NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

1. Ofruesi mund të bëjë dhe të përpunojë regjistrime video, audio ose video dhe audio, duke përdorur një sistem videosurvejimi për qëllime sigurie.

2. Ofruesi mund të përdorë sisteme videosurvejimi për interesa sigurie, nëse bëhet i domosdoshëm nga rrethanat dhe asnjë mjet tjetër nuk mund të ndihmojë në zbulimin e krimit, kapjen e kriminelëve, parandalimin dhe vërtetimin e aktiviteteve të jashtëligjshme, si dhe zbatimi i këtyre pajisjeve teknike përkon vetëm me atë çka është absolutisht e domosdoshme dhe nuk kufizon në mënyrë disproporcionale të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Ofruesi mund të vendosë në funksion një sistem videosurvejimi vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij të qartë. Pëlqimi, gjithashtu, mund të jepet në mënyrë të nënkuptuar. Interpretohet si pëlqim i nënkuptuar, në qoftë se personi fizik hyn në hapësirën private të hapur për publikun, pavarësisht njoftimit informues, përveç kur rrethanat tregojnë të kundërtën në mënyrë të padyshimtë. Njoftimi informues përmban informacion në lidhje me:

- a) qëllimin e survejimit që bëhet me anë të një sistemi elektronik;
- b) qëllimin e marrjes dhe të përpunimit të regjistrimeve video dhe audio, duke përdorur atë sistem;
- c) bazën ligjore për përpunimin e të dhënave;
- ç) vendin ku ruhen regjistrimet;
- d) afatin e ruajtjes;
- dh) personin që drejton sistemin;
- e) dispozitat përkatëse të ligjit për mbrojtjen e të dhënave mbi të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe procedurat për zbatimin e këtyre të drejtave.

4. Sistemi i videosurvejimit nuk përdoret në një zonë ku mund të shkelet dinjiteti njerëzor, veçanërisht në dhomat e zhveshjes, tualete dhe, përveç rasteve që rregullohen në kreun III, gjatë trajtimit mjekësor.

5. Nëse nuk ka përdorime të mëtejshme, regjistrimi fshihet brenda 3 ditëve pune pas regjistrimit. Përdorimi i mëtejshëm nënkupton përdorimin e regjistrimit në gjykatë ose në procedura të tjera administrative si provë.

6. Të drejtat ose interesat ligjore të të cilave janë prekur nga regjistrimi, mund të kërkohen brenda 3 ditëve pune, me lindjen e së drejtës apo të interesit ligjor, që të dhënat të fshihen nga ana e ofruesit. Në qoftë se kjo kërkohet nga gjykata ose organ tjetër administrativ, regjistrimi dërgohet menjëherë në gjykatë ose organ administrativ. Nëse nuk është paraqitur asnjë kërkesë brenda 30 ditëve pas kërkesës për mos fshirje, regjistrimi fshihet.

7. Regjistrimi aksesohet vetëm nga punonjësit e stafit, nëse është e pashmangshme për parandalimin apo ndërprerjen e aktivitetit të paligjshëm. Emrat e punonjësve të stafit që kanë akses në regjistrime, regjistrohen së bashku me qëllimin dhe kohën në të cilën i lejohet aksesit.

8. Kërkesat e përcaktuara në udhëzimin nr. 3, datë 5 mars 2010, i ndryshuar, për sistemet e videosurvejimit të ndërtesave dhe mjediseve të tjera zbatohen edhe për këtë udhëzim.

KREU VIII TË FUNDIT

1. Janë përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi të gjithë kontrolluesit e përcaktuar në pikën 2 të kreut 1 të këtij udhëzimi.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

VENDIM Nr. 143, datë 31.10.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO ALFA&OMEGA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Alfa&Omega”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 659, datë 6.3.2012, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Besnik Verbofshi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 4.12.2012
Doli nga shtypi më 5.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë